

VENDIM
Nr. 6, datë 5.2.2020

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E
KUSHTEVE PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR
MARRËVESHJEN E MBËSHTETJES FINANCIARE BREDA GRUPIT
BANKAR”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja “a”, dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 6, pika 6, dhe të nenit 16, pika 6, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për përcaktimin e kushteve për dhënie e miratimit paraparak për marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETAR
Gent Sejko

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve për dhënie e miratimit paraparak për marrëveshjen e mbështetjes financiare, e cila mund të ofrohet vetëm nga bankat brenda grupit bankar, që është pjesë e mbikëqyrjes së konsoliduar të Bankës së Shqipërisë, si dhe të kërkesave për dokumentacionin dhe përmbajtjen e tij, me qëllim marrjen e këtij miratimi nga Banka e Shqipërisë.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat e licencuara për të ushtruar veprimtari bankare dhe financiare në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3
Baza juridike

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:
 - a) nenit 12, shkronja “a”, dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe
 - b) nenit 16, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”).

Neni 4 **Përkufizime**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar në ligjin “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe në nenin 4, dhe kreun III, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
 - a) “bankë ofruese” është banka, pjesë e grupit bankar, e cila ofron mbështetjen financiare; dhe
 - b) “bankë marrëse” është banka, pjesë e grupit bankar, e cila merr mbështetjen financiare.

KREU II KUSHTET PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR MARRËVESHJEN E MBËSHTETJES FINANCIARE BRENDË GRUPIT BANKAR

Neni 5 **Kërkesa të përgjithshme dhe procedura për dhënien e miratimit paraparak**

1. Banka mund të ofrojë mbështetje financiare brenda grupit bankar në formën e një kredie, garancie ose si kombinim i tyre, për një ose disa banka apo subjekte të grupit bankar, me qëllim ruajtjen apo rivendosjen e gjendjes së qëndrueshme financiare të bankës, subjektit dhe të grupit bankar në tërësi.
2. Banka nuk mund të ofrojë mbështetje financiare brenda grupit bankar, pa miratimin paraparak të Bankës së Shqipërisë. Format e tjera të zakonshme të marrëveshjeve apo marrëdhënieve financiare, midis bankave apo subjekteve të grupit bankar (që konkludohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë normale të tyre) nuk janë objekt i miratimit paraparak në kuptim të kësaj rregullore.
3. Banka e Shqipërisë jep, refuzon ose kufizon dhënien e miratimit paraparak për marrëveshjen, mbi bazën e të cilës do të ofrohet mbështetja financiare brenda grupit bankar, bazuar në vlerësimin e:
 - a) përshtatshmërisë së dokumentacionit të paraqitur nga banka ofruese pranë Bankës së Shqipërisë;
 - b) përmbajtjes së elementëve të marrëveshjes së mbështetjes financiare brenda grupit bankar;
 - c) ndikimeve të mundshme në gjendjen financiare dhe qëndrueshmërinë e bankës ofruese; si dhe
 - d) ndikimeve të mundshme në stabilitetin financiar të vendit.
4. Banka që do të ofrojë mbështetjen financiare, paraqet pranë Bankës së Shqipërisë kërkesën për marrjen e miratimit paraparak të marrëveshjes së mbështetjes financiare brenda grupit bankar dhe dokumentacionin shoqërues përkatës, siç përcaktohet në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

5. Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit, lidhur me dhënien e miratimit paraprak për marrëveshjen e mbështetjes financiare, do të kryhet në dy faza:

a) në fazën e parë, Banka e Shqipërisë shpreh moskundërshtimin e saj për marrëveshjen e propozuar (projekt) të mbështetjes financiare, kur pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur, sipas shkronjës “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 6, krijon bindjen se marrëveshja përfshin të gjithë elementët e përcaktuar në nenin 7, të kësaj rregulloreje;

b) në fazën e dytë, kur banka ofruese do të ofrojë mbështetjen konkrete për bankën marrëse, Banka e Shqipërisë jep miratimin paraprak. Ky miratim jepet vetëm pas plotësimit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, si dhe të vlerësimit të Bankës së Shqipërisë.

6. Banka e Shqipërisë, brenda 2 (dy) muajve, shpreh ose jo moskundërshtimin dhe, brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga paraqitja e dokumentacionit të plotë për ofrimin konkret të mbështetjes financiare, jep, refuzon ose kufizon dhënien e miratimit paraprak të mbështetjes financiare. Shprehja, ose jo, e moskundërshtimit dhe dhënia, refuzimi, ose kufizimi, i miratimit paraprak të mbështetjes financiare jepen me vendim të Administratorit përgjegjës për mbikëqyrjen.

7. Banka që do të ofrojë mbështetjen financiare, njofton Bankën e Shqipërisë në rastet kur mbyllet, pezullohet ose përfundon marrëveshja e mbështetjes financiare, për të cilën është dhënë moskundërshtimi apo miratimi paraprak.

8. Banka njofton Bankën e Shqipërisë, në rastet kur ndryshojnë termat dhe kushtet e marrëveshjes, për të cilat është dhënë moskundërshtimi apo miratimi paraprak. Banka riparaqet dokumentacionin e ndryshuar për shqyrtim dhe vlerësim pranë Bankës së Shqipërisë.

Neni 6

Dokumentacioni që paraqitet pranë Bankës së Shqipërisë

1. Kërkesa për marrjen e miratimit paraprak të marrëveshjes së mbështetjes financiare, paraqitet e shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) tekstin e marrëveshjes së propozuar për mbështetjen financiare brenda grupit të miratuar nga Këshilli Drejtues;

b) të dhënat lidhur me emrat dhe selinë qendrore të bankave dhe/ose subjekteve përbërëse të grupit bankar, të cilët synojnë nënshkrimin e marrëveshjes së mbështetjes financiare brenda grupit bankar; dhe

c) analizën e efekteve të zbatimit të marrëveshjes së propozuar të mbështetjes financiare brenda grupit bankar, që paraqet në veçanti të gjitha përfitimet dhe rreziqet, e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, duke përfshirë ndikimin në vlerat e kapitalizimit dhe të likuiditetit, për aplikuesin dhe për grupin financiar, në rast të ofrimit të mbështetjes financiare, në përputhje me këtë marrëveshje, siç përcaktohet në nenin 8 dhe 9, të kësaj rregulloreje.

2. Banka e Shqipërisë mund të kërkojë nga subjekti aplikues paraqitjen e dokumentacionit shtesë, në qoftë se dokumentet e paraqitur sipas pikave të mësipërme, nuk bëjnë të mundur përcaktimin e të gjithë fakteve të rëndësishme për vendimmarrje. Në këtë rast, afati i Bankës së Shqipërisë për dhënien e vendimit lidhur me marrëveshjen financiare brenda grupit, shtyhet deri në paraqitjen e dokumentacionit shtesë të kërkuar.

3. Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë në gjuhën shqipe, në origjinal ose në kopje të legalizuara. Ai dorëzohet në Bankën e Shqipërisë me zarf të mbyllur ose dërgohet me postë të regjistruar.

Neni 7

Vlerësimi i elementeve të marrëveshjes së mbështetjes financiare brenda grupit bankar

Banka e Shqipërisë, në zbatim të nenit 5, pika 3, shkronja “b”, të kësaj rregulloreje, shqyrton dhe vlerëson nëse marrëveshja e propozuar (projekt) e mbështetjes financiare parashikon elementet e mëposhtme:

a) dispozita të qarta se mbështetja do të ofrohet vetëm në rast se, pas ofrimit të saj, nuk do të preken treguesit rregullatorë të bankës ofruese (niveli minimal rregullator dhe shtesa e kombinuar makroprudenciale e kapitalit);

b) banka ofruese nuk është e detyruar të ofrojë mbështetjen dhe nuk i nënshtrohet ndonjë penalteti për moszbatim të marrëveshjes, nëse nuk mund të respektojë kërkesat e kësaj rregulloreje, në rastin kur kërkohet ofrimi/akordimi i mbështetjes financiare; dhe

c) mbështetja ofrohet vetëm në rast se banka ofruese vlerëson se ka pritshmëri të arsyeshme për korrigjimin e vështirësive financiare të bankës marrëse.

Neni 8

Vlerësim i përfitimeve dhe rreziqeve për grupin dhe për bankën ofruese

1. Banka ofruese, me qëllim që të argumentojë/provojë për Bankën e Shqipërisë se ofrimi i mbështetjes financiare ka si objektiv ruajtjen apo rivendosjen/përmirësimin e gjendjes financiare të grupit në tërësinë e tij, analizon dhe krahason:

a) përfitimet e përgjithshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta për grupin në tërësinë e tij (përfitimet për secilën nga bankat e grupit), që rezultojnë nga një rivendosje/përmirësim i gjendjes financiare të bankës marrëse dhe rreziqet e përgjithshme, të pritshme për pozicionin financiar të grupit nëse nuk ofrohet mbështetja, si dhe rrezikun e një dështimi të bankës marrëse në këtë rast; me

b) rreziqet për grupin, që rezultojnë nga ofrimi i mbështetjes financiare, përfshirë këtu rrezikun e dështimit të bankës marrëse dhe humbjen për grupin, në rast dështimi pas marrjes së mbështetjes.

2. Banka ofruese, me qëllim që të argumentojë/provojë për Bankën e Shqipërisë se ofrimi i mbështetjes financiare është në interesin e bankës ofruese, analizon dhe krahason:

a) përfitimet e përgjithshme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta për bankën ofruese, që rezultojnë nga një rivendosje/përmirësim i shëndetit financiar të bankës marrëse dhe rreziqet e përgjithshme të pritshme për pozicionin financiar të bankës ofruese nëse nuk ofrohet mbështetja, si dhe rrezikun e një dështimi të bankës marrëse në këtë rast; me

b) rreziqet për bankën ofruese, që rezultojnë nga ofrimi i mbështetjes financiare, përfshirë këtu rrezikun e dështimit të bankës marrëse dhe humbjen për bankën ofruese, në rast dështimi të bankës marrëse pas marrjes së mbështetjes.

Analiza dhe vlerësimi i pritshmërisë së korrigjimit të vështirësive financiare të bankës marrëse duhet bazuar në elementet e përcaktuara në nenin 9, të kësaj rregulloreje.

3. Analiza sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të marrë në konsideratë kërkesat për një administrim të mirë/ të shëndetshëm të kapitalit dhe të likuiditetit, në nivel banke individuale dhe grupi bankar, si dhe çdo procedurë apo politikë të brendshme ekzistuese, që administron apo kufizon transaksionet brenda grupit bankar.

4. Banka ofruese, në rastet kur vlerësohet se ofrimi i mbështetjes financiare do të krijonte një kërcënim për stabilitetin financiar të vendit, analizon të paktën faktorët e mëposhtëm:

a) rëndësinë që ka banka ofruese për stabilitetin financiar të vendit, duke marrë në konsideratë lidhjet e ndërsjella mes bankës ofruese dhe bankave të tjera që janë me rëndësi për stabilitetin financiar;

b) kushtet financiare të bankës ofruese dhe të subjekteve të grupit bankar që janë me rëndësi për stabilitetin e tij;

c) probabilitetin e ngjarjeve të ardhshme që kanë një impakt negativ mbi bankën ofruese ose mbi anëtarët e grupit bankar që janë me rëndësi për gjendjen financiare të bankës ofruese ose për stabilitetin financiar të vendit; dhe

d) rrezikun që ofrimi i mbështetjes financiare do t'i reduktojë bankës ofruese likuiditetin apo aktivet, të cilat do të jenë të nevojshme për të mbështetur bankat e tjera të grupit bankar që janë të rëndësishme për stabilitetin e grupit bankar dhe stabilitetin financiar në të ardhmen e afërt.

Nëse banka ofruese nuk është plotësisht e informuar mbi ndikimet e mundshme në stabilitetin financiar të vendit, vlerësimi do të mbështetet në informacionin e disponueshëm.

5. Banka ofruese vlerëson:

a) nëse ofrimi i mbështetjes financiare dëmton aftësinë për ndërhyrje të jashtëzakonshme në bankën ofruese; dhe

b) nëse dhënia e mbështetjes financiare e bën më pak të zbatueshëm dhe të besueshëm zbatimin e strategjisë së ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankën ofruese, siç parashikohet në planin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme.

Ky vlerësim konsideron ndikimin e ofrimit të mbështetjes financiare në:

i. mundësinë e përthithjes së humbjeve brenda grupit, pas përmbushjes së kushteve për ndërhyrje të jashtëzakonshme;

ii. ndërlidhjen e bankës ofruese me bankën marrëse;

iii. rrezikun e efektit zinxhir brenda grupit;

iv. kompleksitetin e grupit, si rrjedhojë e ofrimit të mbështetjes financiare.

Nëse banka ofruese nuk është plotësisht e informuar mbi strategjinë e preferuar për ndërhyrje të jashtëzakonshme, vlerësimi do të mbështetet në informacionin e disponueshëm në planin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

6. Banka ofruese, me qëllim sigurimin e zbatueshmërisë së kërkesave të Bankës së Shqipërisë për kapitalin rregullator dhe mjaftueshmërinë e kapitalit, si dhe shtesën e kombinuar makroprudenciale të kapitalit, administrimin e rrezikut të likuiditetit dhe administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha, si dhe shmangien e shkeljeve të këtyre kërkesave, që mund të rrjedhin nga ofrimi i mbështetjes financiare, paraqet në Bankën e Shqipërisë, në fazën e dytë, informacion se do të vazhdojë t'i përmbushë kërkesat lidhur me mjaftueshmërinë e kapitalit dhe shtesën e kombinuar makroprudenciale të kapitalit, likuiditetin dhe ekspozimet e mëdha, dhe se ofrimi i mbështetjes nuk do të rezultojë në shkelje të tyre në të ardhmen e afërt/të parashikueshme.

Neni 9

Pritshmëria e korrigjimit të vështirësive financiare

1. Në zbatim të kërkesave të nenit 7, shkronja “c”, të kësaj rregulloreje, pritshmëria që mbështetja e ofruar të korrigjojë në mënyrë të konsiderueshme vështirësitë financiare të bankës së grupit bankar që merr mbështetjen financiare (banka marrëse), do të konsiderohet e arsyeshme/argumentuar, vetëm nëse plotësohen kriteret/kushtet e mëposhtme:

a) nevojat për kapital dhe likuiditet të bankës marrëse, aktuale dhe të pritshme, janë të mbuluara për një kohë të mjaftueshme, e cila përfshin një afat kohor nga 3 (tre) muaj deri në 1 (një) vit, në varësi të natyrës së treguesve, duke marrë në konsideratë respektivisht

edhe të gjithë burimet e tjera financiare, përmes të cilëve mund të përmbushen këto nevoja, intervalin kohor që nevojitet për të korrigjuar vështirësitë financiare, si dhe afatin kohor të mbështetjes;

b) analiza e situatës financiare dhe e shkaqeve të brendshme dhe të jashtme të vështirësive financiare, në veçanti e natyrës dhe kompleksitetit të veprimtarisë së bankës marrëse dhe e administrimit të rrezikut nga ana e saj, si dhe analiza dinamike e kushteve të tregut, mbështet pritshmërinë e korrigjimit;

c) një plan veprimi që përshkruan masat për korrigjimin e situatës financiare të bankës marrëse, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, një rishikim të natyrës dhe kompleksitetit të veprimtarisë së saj dhe të administrimit të rrezikut; dhe

d) supozimet në bazë të përshkrimeve dhe parashikimeve të përcaktuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të këtij neni, janë koherente dhe të besueshme/arsyeshme, si dhe marrin në konsideratë kushtet e stresuara të bankës marrëse, kushtet aktuale të tregut dhe zhvillimet potenciale të pafavorshme.

Neni 10

Kërkesat për publikimin e informacionit mbi marrëveshjen e nënshkruar të mbështetjes financiare brenda grupit

1. Banka publikon termat dhe kushtet e përgjithshme të marrëveshjes së mbështetjes financiare brenda grupit, për të cilën është dhënë miratimi paraprak, si dhe në veçanti, informacionin e mëposhtëm:

a) emrat e biznesit të subjekteve përbërës të grupit bankar, që kanë nënshkruar marrëveshjen e mbështetjes financiare;

b) format në të cilat mund të ofrohet kjo mbështetje, si dhe kufizimet individuale për secilën nga këto forma;

c) parimet ku bazohet përlogaritja e vlerësimit për ofrimin e mbështetjes financiare brenda grupit bankar dhe mënyrën sesi ato lidhen me kushtet e tregut, në kohën e mbështetjes;

d) informacion nëse parashikohet reciprociteti i mbështetjes financiare ndërmjet palëve të marrëveshjes së mbështetjes financiare brenda grupit bankar, dhe/ose informacion lidhur me kushtet e ndryshme që aplikohen kundrejt marrësve dhe/ose ofruesve të ndryshëm të mbështetjes financiare, nëse një reciprocitet i tillë nuk ekziston;

e) informacion lidhur me renditjen, maturitetin dhe datën përfundimtare të shlyerjes së detyrimeve, që rrjedhin nga ofrimi i mbështetjes;

f) informacion lidhur me rrethanat dhe/ose treguesit që kanë të bëjnë me veprimet e marrësit dhe/ose ofruesit të mbështetjes, të cilët përfaqësojnë bazën për ofrimin e kësaj mbështetjeje; dhe

g) informacion lidhur me kolateralin e parashikuar për ofrimin e mbështetjes financiare.

2. Banka publikon qartësisht në faqen e saj zyrtare të internetit, informacionin e sipërpërmendur, me emërtimin “Informacion lidhur me marrëveshjen e mbështetjes financiare brenda grupit bankar”, si dhe duhet të përditësojë këtë informacion të paktën një herë në vit, dhe/ose pa vonesë, në rast ndryshimesh që i bëhen marrëveshjes së mbështetjes financiare brenda grupit.

KREU III
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 11
Sanksionet

Banka e Shqipërisë, në rastet kur banka nuk njofton mbi marrëveshjet për mbështetje financiare brenda grupit bankar, zbaton sanksionet e përcaktuara në nenin 81, të kreut XI, të ligjit “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme”.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko